



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 20**

Datë: 26. 05. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
2. Zëvendësimi i Anëtarit të KKZ-së në Zubin Potok
3. Shqyrtimi dhe miratimi i pagesave pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend 2017
4. Të ndryshme

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Mirë se keni ardh në mbledhjen e radhës të 20-të.

### **2. Zëvendësimi i Anëtarit të KKZ-së në Zubin Potok**

**Enis Halimi:** Është një informatë prej KKZ-së e cila, është ballafaquar me mungesën e anëtarit përkatës. Dhe si trupë e implementimit të zgjedhjeve, KKZ-ja ka marrë vendim atje, të cilin besoj e keni të bashkëlidhur qoftë serbisht, edhe është i përkthyer vendimi. Kanë propozuar ata

që në bazë të drejtës ligjore me emëruar një anëtar tjetër, për shkak se atje balanca është tre me tre. Kështu që ne kemi proceduar në KQZ për t'a formalizuar emërimin e këtij propozimi nëse është gjithçka në rregull.

**Valdete Daka:** Po urdhëro!

**Betim Gjoshi:** Nëse më lejoni...? Ky nuk është zëvendësim. Është emërim i ri. Zëvendësim kuptohet që nëse brenda të njëjtit subjekt nominohet, ndërrohet personi. Këtu i bie ne ta shkarkojmë një person dhe ta emërojmë një tjetër. Për mua, është e pa arsyeshme. Unë nuk kam asnjë shpresë çka ka marrë KZ-ja, por edhe me pas nuk është që KKZ-ja emëron KKZ. Nuk ka asnjë bazë në këtë fushë. Kështu që unë jam kundër, nuk kam çka të shtojë....

**Adnan Rrustemi:** Pse me na ardhur prej Sekretariatit neve, në këtë mënyrë?! Nuk po na thuhet që në fillim. Mos ta kish evidentuar Betimi në këtë rast, unë kisha menduar që po bëhet fjalë për zëvendësim, a po kupton? S'po na thotë këtu..., tabelën e vjetër nuk e kemi, për me na tregu ndonjë propozim.

**Valdete Daka:** Qe ku është SLS ka qenë, ndërkaq kjo është OJIK d.m.th. KKZ-ja po e bën propozimin.

**Enis Halimi:** Propozimi i KKZ-së, është ballafaquar me mungesën e anëtarit në...

**Binak Vishaj:** E, çfarë është kjo "OJIK"...? Kjo, Oliviera, kënd e përfaqëson kjo...?

**Adnan Rrustemi:** Kjo është KKZ, është i propozuari, e i shkarkuari SLS-ja, po pse SLS-ja po shkarkohet...Po përse nuk e dërgon tjetrin partia...? A po e kuptoni? Pse...?

**Valdete Daka:** Ajo parti, le ta dërgojë.... Janë duke i kërcënuar, a...?

**Sami Hamiti:** Është dashur me e thanë atë që, është duke ndodhur! Janë duke i kërcënuar... Edhe, jo...! Unë jam kundër. Le të zëvendësohet me SLS. Nëse nuk dojnë, hiç....Unë po e shoh çka është duke ndodhur...! SLS nëse do, le ta zëvendësojë...

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i pagesave pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend 2017**

**Valdete Daka:** Faliminderit! Vazhdojmë me pikën tjetër. Shqyrtimi dhe miratimi i pagesave të stafit të angazhuar në qendrat e votimit dhe vendvotime për zgjedhje të parakohshme. E kemi këtu një draftvendim. A është i njëjti sikurse në zgjedhjet tjera?

**Enis Halimi:** Po. Ndoshta përveç numrit 7, ku ka qenë 55 euro, tash është 50 euro e 50 cent pagesa. E kemi konsideruar që ka qenë e mjaftueshme për shkak se, nuk është e arsyeshme. Si e tillë është e njëjta në aspekt.

**Betim Gjoshi:** Para se me e miratuar, ma jepni një shpjegim, sepse krejt këto kategori janë ato që e kemi biseduar, që janë ndalur, në qoftë se janë në njëra prej skemave sociale. A e keni marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, a jo?

**Enis Halimi:** Kemi provuar që ta kontaktojmë ministrinë përkatëse, dhe jemi në përpjekje për t`a kontaktuar nivelin e administratës të kësaj ministrie. Kemi marrë hapa, por nuk kemi marrë përgjigje.

**Adnan Rrustemi:** Pse nuk po e dërgoni një here një shkresë sekretarit permanent...?

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për këtë vendim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin e pagesave pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend 2017

### **Të ndryshme**

**Adnan Rrustemi:** Unë, mendova që është mirë ti përfundojmë fletëvotimin, por ndoshta nesër mbledhemi. Duhet me qenë efikas për votimin jashtë vendit...!

**Sami Hamiti:** Ne jemi dakord që hapësira në fletëvotim të jetë i barabartë për të gjithë. Gjejeni formatin si te bëni. Kaq! Ne e votojmë. Por, hapësira, distanca mes partive në këtë pjesë, pse kanë shumë gjejeni formatin si të bëjmë, nëse doni që t`a votojmë. Kaq! U kry. Gjejeni...

**Eshref Vishi:** Po e vazhdojmë ne në Komisionin për Informim...

**Adnan Rrustemi:** Jo, nuk mundemi edhe bash kështu...!

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----